



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Tiranë, më. 22.01.2024

## Njoftim për bashkëpunëtorë

### Asnjë fëmijë pas në shkollat dhe kopshtet gjithëpërfshirëse në Shqipëri

Në kuadër të projektit të Edukimit “Asnjë fëmijë pas në shkollat dhe kopshtet gjithëpërfshirëse në Shqipëri”, i mbështetur dhe zbatuar nga Save the Children në partneritet me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) kërkon bashkëpunëtorë të jashtëm.

Bashkëpunëtorët duhet të plotësojnë këto kërkesa:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë.
2. Të kenë përvojë paraprake në punën për zbatimin e standardeve të nismës Shkolla si Qendër Komunitare, menaxhimin e institucionit arsimor dhe veprimtarive në kuadër të SHQK-së.
3. Të kenë marrë pjesë në projekte dhe veprimtari që lidhen me zhvillimin profesional të mësuesve në arsimin parauniversitar (përgatitje e materialeve për trajnimin e mësuesve, zhvillim i trajnimeve etj.)
4. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.
5. Preferohen përfshirjet afatgjata në fushat e mësipërme të veprimtarive.
6. Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.

Kandidatët duhet të dorëzojnë CV-në dhe këto dokumente (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë, të dokumentit të identitetit) pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) , brenda datës 26.01.2024, ora 16.30.

***Faleminderit!***